



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 46/16/1 Prot

Elbasan më 13 /08/2026

VENDIM

Nr 97 datë 13 /08/2026.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin KORRIK 2026

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar , ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 13 /08/2026

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin KORRIK 2026 , 73 familje me fond 224.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Miratoi: Dr Përgjithshëm
Drejtor Dr Juridike
Drejtor Dr Finance
Konfirmoi: Zv/Kryetar

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elsid Zyma

M.Duka
D.Shuli
E.Arapi
A.Merkja
R.Haxhijaj

Kryetar i Këshillit Bashkiak


Lutfi Lala

Miraturar me _____ vota

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____



4616/2.

13.08.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 9371 Prot

Elbasan, më 13.8.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.97, datë 13.08.2026 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Korrik 2026”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLICA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 4615/1 Prot

Elbasan më 13 /08/ 2026

VENDIM

Nr. 98 datë 13 /08/2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi ikushtëzuar për muajin Korrik 2026

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 13 /08/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Shërbimit Social

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **KORRIK 2026** për **243** familje me një fond prej **1.141.434** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori

Pranoi : Dr Përgjithshëm

Drejtor Dr Juridike

Drejtor Dr Finance

Konfirmoi: Zv/Kryetar

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Miratuar me _____vota

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

M.Duka

D.Shuli

E.Arapi

A.Merkja

R.Haxhiaj

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

4615/2.
13.08.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 939/1 Prot

Elbasan, më 13.8.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.98, datë 13.08.2026 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2026”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





940
13.08.2026



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q. Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

Nr. 4517/1 Prot.

Elbasan më, 13.08.2026

VENDIM

Nr. 99 Datë 13.08.2026

“Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT Albania), në kuadër të projektit IPA-ADRION00107 "ARCA – Platformë e inteligjencës artificiale për parandalimin e rreziqeve natyrore të ndryshimeve klimatike"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile) si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Të miratojë memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT Albania), në kuadër të projektit IPA-ADRION00107 "ARCA – Platformë e inteligjencës artificiale për parandalimin e rreziqeve natyrore të ndryshimeve klimatike".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile) si edhe Drejtoria e Integritimit Evropian, Projekteve dhe Donatorëve.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elsid Zyma



Konceptoi:

Specialist

I. Hoxholli

Pranoi:

Drejtori MC

N. Sinani

Miratoi:

Dr. PPMCMBPk Sh. Çullhaj

Dr. Juridike

E. Arapi



Konfirmoi:


Zv/Kryetari

A.Sula



KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 940/ Prot.

Elbasan më 138. 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligshmërisë së aktit tuaj nr.99 datë 13.08.2026 “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT Albania), në kuadër të projektit IPA-ADRION00107”ARCA-Platformë e inteligjencës artificiale për parandalimin e rreziqeve natyrore të ndryshimeve klimatike” konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

